QAINT
Quality, Accountability, Integrity and Transparency in Higher Education

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

NËNTOR 2020 – DHJETOR 2021

RAPORT I MONITORIMIT TË QENDRËS KOMBËTARE PËR NJOHJE TË DIPLOMAVE (NARIC KOSOVA)

3



RAPORT I MONITORIMIT TË QENDRËS KOMBËTARE PËR NJOHJE TË DIPLOMAVE (NARIC KOSOVA) 3

NËNTOR 2020 – DHJETOR 2021

Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
www.orca-ks.org
info@orca-ks.org
Henrik Bariç, Nr. 6
Prishtina, 10000, Kosova

Autore:
Liridona Ademaj

Dizajni:
Envinion

Prishtinë, mars 2022



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

TABELA E PËRMBAJTJES

Definime....8

Listë e shkurtesave....9

Hyrje....10

Vendimet nga Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik....11
- Vendimet e Këshillit Shtetëror për Njohje (KShNj)....12
- Vendimet nga stafi i Zyrës së Qendrës....17
- Diploma pa vendim për njohje apo mosnjohje....20

Validimi i diplomave në NARIC KOSOVA....21

Sfidat e Qendrës NARIC Kosova....23
- Databaza online....23
- Databaza interaktive....23
- Staf i pamjaftueshëm....23
- Mungesa e rregullores për Këshillin Shtetëror për Njohje....24
- Diplomat pezull nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri....24
- Mungesa e një ligji të veçantë për NARIC....25
- Humbja e rasteve në gjykatë....25
- Njohja e diplomave nga Komisioni i Ankesave dhe paditë e KShNj-së ndaj tyre....25

Grumbullimi i shkeljeve dhe parregullsive në procesin e njohjes së diplomave përgjatë viteve....27
- Komisioni për verifikimin e diplomave të lëshuara nga IAL-të në Kosovë....28

Përfundime....30

Rekomandime....31

Legjislacioni dhe procedurat e njohjes....32

DEFINIME

- **Njohje –** do të thotë një pranim zyrtar nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë (MAShTI), i një diplome të fituar jashtë vendit, e cila e konfirmon saktësinë dhe vërtetësinë e saj.

- **Barasvlerë –** do të thotë një pranim zyrtar nga ana e MAShTI-it i një diplome të fituar jashtë vendit, e cila e konfirmon saktësinë dhe vërtetësinë e saj dhe bën krahasueshmërinë me nivelin e diplomave dhe fushës studimore përkatëse në vend.

- **Validim -** Vlefshmëria e diplomës vërteton ekuivalencën e kredive dhe të diplomës së çdo certifikimi të fituar në cilindo nga institucionet e akredituara në Kosovë, që mbajnë një akreditim ekuivalent. Ky shërbim i certifikimit të diplomës ka për qëllim lehtësimin e pranimit të diplomave dhe kredive të fituara nga institucionet e akredituara brenda vendit.

- **Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC – National Academic Recognition and Information Center)** - përbëhet nga Zyra e Qendrës dhe Këshilli Shtetëror për Njohje dhe ofron informacion në procedurat për njohjen e diplomave dhe kualifikimeve të huaja, si dhe ofron informata për sistemin e arsimit të lartë dhe kualifikimet në Kosovë me kërkesë të shteteve të tjera.

- **Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj)** - është organ i cili merr vendime për njohje/barasvlerë apo mosnjohje/mosbarasvlerë, duke u bazuar në dosjen e parashtruesit të kërkesës dhe raportin e përgatitur nga zyrtari i Qendrës dhe në raste të veçanta, bazuar në rekomandimin e komisionit të ekspertëve. Përbëhet nga profesorë universitar të fushave të ndryshme studimore.

LISTË E SHKURTESAVE

- **MASHTI –** Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë
- **NARIC KOSOVA -** Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik
- **KShNj -** Këshilli Shtetëror për Njohje
- **MASR -** Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri
- **Niveli 5 –** Shkollë e lartë profesionale
- **BA –** Studimet themelore Baçelor i Arteve
- **BSc** – Niveli i studimeve themelore Baçelor i Shkencës
- **MA –** Studimet Master i Arteve
- **MSc** – Niveli i studimeve Master i Shkencës
- **PhD –** Studimet e doktoratës
- **ORCA –** Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

HYRJE

Numri i studentëve të diplomuar në universitete publike dhe kolegje private në Kosovë, të cilët po i validojnë diplomat e tyre për të dalë jashtë vendit është në rritje. Gjatë vitit 2021, janë validuar 3263 diploma nga nivele të ndryshme studimi.

Në ndërkohë është në rritje edhe numri i studentëve që kanë përfunduar apo janë ende në studime e të cilët kanë evidentuar probleme të ndryshme të cilat po ua humbasin vlefshmërinë e diplomës apo studimeve të deritanishme si pasojë e mosdorëzimit të librave amëz në Ministri të Arsimit nga ana e institucioneve të arsimit të lartë, tejkalimit të kuotës së studentëve në programe të ndryshme studimi e të tjera.

Ky raport është rezultat i monitorimit të punës së Këshillit Shtetëror për Njohje (KShNj) në kuadër të qendrës NARIC Kosova, për periudhën nëntor-dhjetor të vitit 2020 dhe janar-dhjetor të vitit 2021.

ORCA ka qenë e pranishme në të gjitha mbledhjet e mbajtura nga KShNj, si dhe ka mbajtur takime të vazhdueshme me stafin e Zyrës së Qendrës NARIC, bashkë me të cilët edhe është bërë evidentimi i sfidave me të cilat vazhdojnë të përballen gjatë realizimit të punës së tyre.

Një ndër problemet më të mëdha dhe qenësore në punën e kësaj qendre dhe këshillit të saj, mbetet mungesa e një ligji të veçantë i cili rregullon të gjithë funksionimin e saj dhe i cili mbron vendimet e Qendrës NARIC para gjykatave të cilat veç kanë marrë vendime për njohje të diplomave të refuzuara nga Qendra NARIC, e që konsiderohen jashtë fuqisë dhe gjykimit të tyre.

Raport të natyrës së njëjtë për këtë institucion, ORCA ka publikuar edhe në nëntor të vitit 2020[1] dhe në shkurt të vitit 2020[2].

1 "Raporti i monitorimit të NARIC KOSOVA 2", nëntor 2020, linku: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/RAPORTI-I-MONITORIMIT-TE-NARIC-KOSOVA-2.pdf
2 "Raporti i monitorimit të NARIC KOSOVA", shkurt 2020, linku: http://orca-ks.org/ëp-content/uploads/2017/02/RAPORTI-I-MONITORIMIT-T%C3%8B-NARIC-KOSOVA-ALB-03.pdf

VENDIMET NGA QENDRA KOMBËTARE PËR NJOHJE DHE INFORMIM AKADEMIK

Në periudhën kohore nëntor dhe dhjetor të vitit 2020, janë marrë gjithsej 262 vendime nga Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC Kosova) si dhe nga Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj).

Ndërkaq gjatë muajve janar-dhjetor të vitit 2021, janë marrë gjithsej 1 mijë e 95 vendime rreth njohjes së diplomave nga NARIC Kosova si dhe nga KShNj.

Ndërkohë në proces janë 203 diploma të cilave ende nuk u është dhënë përgjigje nga Qendra për Njohje të Diplomave si pasojë e mungesës së përgjigjeve zyrtare nga institucionet ku palët i kanë përfunduar studimet, apo nga qendrat NARIC të shteteve përkatëse.


Për krahasim, në periudhën kohore janar-tetor të vitit 2020, ishin marrë gjithsej 663 vendime nga Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik, ndërkohë që në proces ishin 194 diploma të cilave nuk u ishte dhënë ende përgjigje rreth njohjes për shkak të mungesës së përgjigjeve nga institucionet ku palët i kishin përfunduar studimet, apo nga qendrat NARIC.

Vendimet e Këshillit Shtetëror për Njohje (KShNj)

Pjesë e këtyre vendimeve, janë diplomat e fituara në Institucione të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat jashtë Republikës së Kosovës.

Gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2020, Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj) ka mbajtur dy mbledhje prej të cilave janë njohur 122 diploma ndërkohë që nuk është njohur një.

Pasqyrë e vendimeve të Këshillit Shtetëror për Njohje gjatë 2020




Në mbledhjen e nëntorit, KShNj ka njohur pesë (5) diploma të nivelit Baçelor, shtatë (7) të nivelit Master dhe katër (4) të nivelit të doktoratës. Gjithsej janë njohur 16 diploma, ndërkaq nuk e ka njohur një diplomë të nivelit 5.

Në mbledhjen e muajit dhjetor, janë njohur katër (4) diploma të nivelit 5 nga KShNj, 41 diploma të nivelit Baçelor, 37 të nivelit Master dhe 24 të nivelit të doktoratës. Gjithsej janë njohur 106 diploma në këtë periudhë.

Pasqyrë e vendimeve të Këshillit Shtetëror për Njohje gjatë 2020

DHJETOR 2020



Gjatë vitit 2021, Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj) ka mbajtur gjithsej dhjetë mbledhje; më 12 shkurt, 24 mars, 11 maj, 26 maj, 21 qershor, 1 shtator, 15 tetor, 15 nëntor, 1 dhjetor dhe 30 dhjetor përmes të cilave janë marr 569 vendime rreth njohjes apo mosnjohjes së diplomave.

Gjithsej KShNj ka marrë vendime pozitive për 560 lëndë, 16 të nivelit të pestë, 174 të nivelit Baçelor, 241 të nivelit Master dhe 129 të nivelit të doktoratës. Vendim negativ kanë dhënë për 9 diploma të nivelit të 5.

Në mbledhjen e mbajtur në shkurt të vitit 2021, KShNj ka njohur gjithsej 3 diploma të nivelit të 5 ndërsa nuk i ka njohur 7 të tilla, ka njohur 27 diploma të nivelit Baçelor, 31 diploma të nivelit Master dhe 16 të nivelit të doktoratës. Pra ka vendosur për 84 diploma.

Në mbledhjen e mbajtur në muajin mars, KShNj nuk i ka njohur dy diploma të nivelit të 5, ndërsa i ka njohur 22 diploma të nivelit Baçelor, 13 të nivelit Master dhe 11 të nivelit të doktoratës. Pra është marrë vendim për 48 diploma nga nivele të ndryshme studimi.

Në mbledhjet e mbajtura në muajin maj, KShNj ka njohur 3 diploma të nivelit të 5, 22 diploma të nivelit Baçelor, 17 diploma të nivelit Master dhe 17 diploma të nivelit të doktoratës. Pra ky këshill ka marr vendim për 59 diploma.

Ndërkaq në mbledhjen e muajit qershor, KShNj ka njohur një diplomë të nivelit të 5, 21 diploma të nivelit Baçelor, 23 diploma të nivelit Master dhe 32 diploma të nivelit të doktoratës. Pra është marrë vendim për 77 diploma nga nivele të ndryshme studimi.

Gjatë muajit korrik, KShNj ka njohur 14 diploma të nivelit Baçelor, 12 të nivelit Master dhe 8 të nivelit të doktoratës. Pra janë njohur gjithsej 34 diploma.

Në mbledhjen e muajit shtator. KShNj ka njohur 9 diploma të nivelit Baçelor, 13 diploma të nivelit Master dhe 12 diploma të nivelit të doktoratës. Pra është marrë vendim për 34 diploma nga nivele të ndryshme studimi.

Në mbledhjen e muajit tetor, KShNj ka njohur një diplomë të nivelit të 5, 15 diploma të nivelit Baçelor, 85 diploma të nivelit Master dhe 11 diploma të nivelit të doktoratës. Pra ky këshill ka marr vendim për 112 diploma.

Në mbledhjen e muajit nëntor, KShNj ka njohur 2 diploma të nivelit të 5, 12 diploma të nivelit Baçelor, 2 diploma të nivelit Master dhe 6 diploma të nivelit të doktoratës. Pra janë njohur gjithsej 22 diploma.

Ndërkaq në mbledhjet e mbajtura në muajin dhjetor, KShNj ka njohur 6 diploma të nivelit të 5, 32 diploma të nivelit Baçelor, 45 diploma të nivelit Master dhe 16 diploma të nivelit të doktoratës. Pra është marrë vendim për 99 diploma nga nivele të ndryshme studimi.

Për krahasim, në raportin e kaluar me të dhëna për vitin 2020, Këshilli Shtetëror për Njohje kishte marrë vendime pozitive apo kishte njohur 336 diploma, prej të cilave 8 ishin të nivelit të pestë, 145 të nivelit Baçelor, 93 të nivelit Master dhe 90 të nivelit të doktoratës. Ndërkohë që vendim negativ apo mosnjohje kishte pasur për një diplomë të nivelit Baçelor.

Pasqyrë e vendimeve të Këshillit Shtetëror për Njohje gjatë 2021

	Janar	Shkurt		Mars		Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
	n/a	Pozitiv	Negativ	Pozitiv	Negativ	n/a	Pozitiv	Pozitiv	Pozitiv	n/a	Pozitiv	Pozitiv	Pozitiv	Pozitiv
Niveli 5		3	7		2		3	1				1	2	6
BA-BSc		27		22			22	21	14		9	15	12	32
MA-MSc		31		13			17	23	12		13	85	2	45
PhD		16		11			17	32	8		12	11	6	16
Total		**77**	**7**	**46**	**2**		**59**	**77**	**34**		**34**	**112**	**22**	**99**
Total						**569**								

Vendimet nga stafi i Zyrës së Qendrës

Përveç diplomave që njihen nga Këshilli Shtetëror për Njohje, njohja e disa diplomave bëhet edhe nga stafi i Zyrës së Qendrës NARIC dhe kjo bëhet vetëm për diplomat e fituara në universitete botërore të mirënjohura si dhe ato publike rajonale.

Gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2020, zyra NARIC ka njohur gjithsej 139 diploma. Janë njohur 51 diploma të nivelit Baçelor, 68 diploma të nivelit Master dhe 20 diploma të nivelit të doktoratës.

Ndërsa gjatë vitit 2021, Zyra e Qendrës NARIC ka njohur gjithsej 526 diploma të nivele të ndryshme të studimit.

Në muajin shkurt është njohur një diplomë e nivelit të pestë, 39 diploma të nivelit Baçelor, 58 diploma të nivelit Master dhe 18 diploma të nivelit të doktoratës. Gjithsej janë njohur 116 diploma.

Gjatë muajit mars, janë njohur 31 diploma të nivelit Baçelor, 41 diploma të nivelit Master dhe 6 diploma të nivelit të doktoratës. Janë njohur gjithsej 78 diploma.

Ndërsa në muajin maj, janë njohur 21 diploma të nivelit Baçelor, 49 diploma të nivelit Master dhe 16 diploma të nivelit të doktoratës. Janë gjithsej 86 njohje të diplomave nga nivele të ndryshme.

Në muajin qershor, janë njohur 8 diploma të nivelit Baçelor, 14 diploma të nivelit Master dhe 10 diploma të nivelit të doktoratës. Janë njohur gjithsej 32 diploma.

Gjatë muajit korrik, janë njohur 13 diploma të nivelit Baçelor, 24 diploma të nivelit Master dhe 7 diploma të nivelit të doktoratës. Janë gjithsej 44 njohje të diplomave nga nivele të ndryshme studimi.

Në muajin gusht, janë njohur 5 diploma të nivelit Baçelor, 13 diploma të nivelit Master dhe 6 diploma të nivelit të doktoratës. Janë njohur gjithsej 24 diploma.

Ndërkaq gjatë muajit shtator, janë njohur 2 diploma të nivelit Master dhe 5 diploma të nivelit të doktoratës. Pra janë njohur gjithsej 7 diploma.

Në muajin tetor, janë njohur 18 diploma të nivelit Baçelor, 35 diploma të nivelit Master dhe 11 diploma të nivelit të doktoratës. Janë gjithsej 64 njohje të diplomave nga nivele të ndryshme studimi.

Gjatë muajit nëntor, janë njohur 6 diploma të nivelit Baçelor, 22 diploma të nivelit Master dhe 4 diploma të nivelit të doktoratës. Janë njohur gjithsej 32 diploma.

Në muajin dhjetor, janë njohur 17 diploma të nivelit Baçelor, 24 diploma të nivelit Master dhe 2 diploma të nivelit të doktoratës. Pra janë njohur gjithsej 43 diploma nga nivele të ndryshme studimi.

Për krahasim, vetëm gjatë periudhës janar-tetor të vitit 2020, numri i përgjithshëm i njohjeve të diplomave nga Zyra e Qendrës NARIC kishte arritur në 288. Prej tyre, një diplomë nga niveli i pestë ishte njohur, 97 diploma ishin miratuar nga niveli Baçelor, 114 nga niveli Master dhe 76 nga niveli i doktoratës.

Siç u përmend më lartë, zyrtarët e Qendrës NARIC bënin njohjen e diplomave të fituara në universitete botërore të mirënjohura si dhe ato publike rajonale, mirëpo në mbledhjen e fundit të vitit 2021, Qendra NARIC i kishte kërkuar Këshillit Shtetëror për Njohje (KShNj) që të marrin përsipër edhe shqyrtimin e diplomave të cilat deri në atë kohë shqyrtohesh-in dhe kalonin për nënshkrim tek udhëheqësja e divizionit për Njohje dhe Barasvlerë të Diplomave pa kaluar tek KShNj.

Pasqyrë e njohjeve nga stafi i Qendrës NARIC gjatë vitit 2021

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
	Nuk ka pasur takim	Pozitiv	Pozitiv	Nuk ka pasur takim	Pozitiv	Pozitiv	Pozitiv	Pozitiv	Pozitiv	Pozitiv	Pozitiv	Pozitiv
Niveli 5		1										
BA-BSc		39	31		21	8	13	5		18	6	17
MA-MSc		58	41		49	14	24	13	2	35	22	24
PhD		18	6		16	10	7	6	5	11	4	2
Total		**116**	**78**		**86**	**32**	**44**	**24**	**7**	**64**	**32**	**43**
Total					**526**							

Diploma pa vendim për njohje apo mosnjohje

Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC Kosova), për periudhën janar-dhjetor 2021 ka gjithsej 203 diploma të cilat ende gjenden në proces të njohjes dhe për të cilat nuk është dhënë një vendim për njohje apo mosnjohje.

Numri i këtyre diplomave që janë lënë pa përgjigje, e të cilat vijnë nga shteti i Shqipërisë është 75, nga shteti i Maqedonisë së Veriut janë 48 diploma, ndërkaq numri i përgjithshëm i lëndëve pa përgjigje nga vendet e tjera është 80.

Për krahasim, në raportin e kaluar të vitit 2020, ishin gjithsej 194 diploma të cilat ende nuk kishin marrë një përgjigje nga NARIC Kosova për njohje apo mosnjohje.

Numri i diplomave që ishin pa një përgjigje, e të cilat vinin nga shteti i Shqipërisë ishte 68, nga shteti i Maqedonisë së Veriut ishin 47 diploma, ndërkaq numri i përgjithshëm i lëndëve pa përgjigje nga vendet e tjera ishte 79.

Arsyet që këto diploma kanë mbetur pa një vendim për njohje apo mosnjohje nga Qendra NARIC, mbesin të ngjashme me ato në raportin e fundit të publikuar nga ne e të cilat ishin; ***Nuk ka përgjigje nga institucionet ku kandidatët i kanë përfunduar studimet; Nuk ka informacion lidhur me akreditimin e programit apo institucionit dhe NARIC Kosova është në pritje të përgjigjes për akreditim; Diplomat vijnë nga institucione të shteteve që nuk e njohin Kosovën si shtet; Vonesat në përgjigje nga institucionet e Turqisë; Përgjigje të paqarta rreth vlefshmërisë së diplomës nga institucionet e Shqipërisë;*** e të tjera.

NUMRI I DIPLOMAVE PA VENDIM PËR NJOHJE APO MOSNJOHJE NË VITIN 2021



Shqipëri

↓

75



Maqedoni e Veriut

↓

48

Vende të tjera

↓

80

TOTAL

↓

203

VALIDIMI I DIPLOMAVE NË NARIC KOSOVA

Bazuar në të dhënat e grumbulluara nga kjo qendër, komponenta e validimit të diplomave të fituara brenda Kosovës me qëllim të përdorimit të tyre jashtë vendit, gjatë vitit 2021 ka arritur gjithsej në 3263.

Nga institucionet e arsimit të lartë publik, përgjatë vitit 2021 janë validuar gjithsej 1774 diploma, ndërkaq nga institucionet e arsimit të lartë privat janë validuar gjithsej 1489 diploma.

Qendra NARIC ende nuk e ka krijuar një rubrikë të veçantë përmes të cilës palët mund të deklarohen se për çfarë arsye po e bëjnë validimin, mirëpo sipas tyre, në të shumtën e rasteve palët janë vetdeklaruar për motivin e validimit të diplomës dhe besojnë se rreth 30 për qind e tyre, shkojnë jashtë vendit për vazhdim të studimeve, ndërsa rreth 70 për qind e tyre, e validojnë diplomën për të kërkuar një punë jashtë Kosovës.

Bazuar në të dhënat e grumbulluara nga kjo qendër, komponenta e validimit të diplomave të fituara brenda Kosovës me qëllim të përdorimit të tyre jashtë vendit, gjatë vitit 2021 ka arritur gjithsej në 3263.

VERIFIKIMI I DIPLOMAVE TË VALIDUARA NGA NARIC, TË LËSHUARA NGA UNIVERSITETET PUBLIKE DHE KOLEGJET PRIVATE NË KOSOVË GJATË VITIT 2021

	Publike	Private	Gjithsej
Janar	59	41	100
Shkurt	131	101	232
Mars	146	112	258
Prill	133	117	250
Maj	106	112	218
Qershor	172	151	323
Korrik	123	118	241
Gusht	102	105	207
Shtator	201	174	375
Tetor	206	152	358
Nëntor	196	130	326
Dhjetor	199	176	375
Gjithsej	1774	1489	3263

SFIDAT E QENDRËS NARIC KOSOVA

Databaza online

Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik vazhdon të funksionojë pa një databazë digjitale.

Që nga shtatori i vitit 2018, NARIC-u është duke funksionuar pa një databazë online, e cila përmban të dhëna për të gjitha lëndët që kanë pranuar, ato të cilat janë në proces dhe për ato që i kanë shqyrtuar. Zyrtarët në NARIC detyrohen që për çfarëdo informacioni, kërkimin ta bëjnë në mënyrë fizike mes dokumenteve në arkiv. Andaj, përsëri propozohet krijimi i një databaze digjitale, e cila do të mundësonte ruajtjen/arkivimin e të dhënave për njohjet/barasvlerën e diplomave ndër vite.

Databaza interaktive

Një databazë e tillë do të shërbente për shtetet e tjera, të cilat kanë nevojë për informata rreth sistemit të arsimit në Kosovë. Ajo gjithashtu do t'ua lehtësonte procedurat studentëve kosovarë të cilët për arsye të ndryshme, i përdorin diplomat e tyre jashtë vendit. Kjo qendër ende nuk posedon as databazë për sistemin e arsimit parauniversitar dhe të lartë në Kosovë të cilat do të duhej të publikoheshin në ueb të NARIC-ut.

Staf i pamjaftueshëm

Qendra NARIC vazhdon të përballet me mungesë të dukshme të stafit përmes të cilëve do të bëhej shpërndarja e shqyrtimit të lëndëve mes zyrtarëve. Kjo sfidë vazhdon të jetë aktuale për shkak të pamundësisë së rekrutimit si pasojë e mungesës së riorganizimit të një organogrami nga Ministria e Arsimit dhe divizioneve brenda saj e cila thuhet se ende është në proces e sipër. Rekrutimi i përkohshëm i kontraktorëve/ekspertëve individual ende bëhet përmes platformës e-prokurimi.

Propozohet sërish që për këtë qendër, të ketë mbështetje me staf profesional për kohë të caktuar siç është angazhimi i ndonjë eksperti me përvojë relevante.

Mungesa e rregullores për Këshillin Shtetëror për Njohje

Siç është gjetur edhe në raportin e kaluar, Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj), vazhdon të punojë pa një rregullore të punës dhe pavarësisht kërkesave të kësaj qendre në Ministri të Arsimit, ky dokument ende nuk është realizuar.

Krijimi i një rregulloreje të tillë, do të mundësonte përcaktimin e punës së këtij këshilli siç janë thirrja e mbledhjes, organizimi i mbledhjes, mënyra e vendosjes apo votimit për lëndë, zbatimi i vendimeve dhe çështje të tjera.

Këshilli punon duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 12/2018 për Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës dhe sipas tyre është e nevojshme të bëhet plotësim/ndryshimi i tij.

Diplomat pezull nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri

Ka vite që Qendra Kombëtare për Njohje të Diplomave në Kosovë, ka vonesa në kthimin e një përgjigjeje palëve apo në njohjen e diplomave të tyre të fituara në Republikën e Shqipërisë. Ky problem vazhdon të mbetet aktual si pasojë e përgjigjeve kontradiktore të institucioneve relevante atje e veçmas për diplomat e fituara në universitetet private në Shqipëri.

Në nëntor të vitit 2021, Republika e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë kishin nënshkruar një marrëveshje për njohje të diplomave mes të dyja shteteve e cila obligonte të dyja vendet që t'i përgjigjeshin institucioneve relevante brenda 15 ditësh, por sipas zyrtarëve të Qendrës në Kosovë, kjo marrëveshje është duke u zbatuar vetëm pjesërisht nga ana e Shqipërisë dhe për pasojë, vazhdon të mbetet sfiduese sigurimi i përgjigjeve për vlefshmërinë e diplomave të fituara në Institucionet e Arsimit të Lartë privat në Shqipëri.

Në raportin e kaluar, Qendra NARIC në Kosovë kishte deklaruar se Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri (MASR) i ka dërguar dokumente në të cilat është vërejtur ndryshimi i përgjigjes nga negative në pozitive pa ndonjë arsyetim të bazuar, si dhe ka vendosur një rubrikë të veçantë në disa prej dokumenteve ku ishte shënuar *"Vërejtje"* dhe në të cilën shkruhet *"MASR nuk është përgjegjëse për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në formular".*

Mungesa e një ligji të veçantë për NARIC

Qendrës Kombëtare për Njohje të Diplomave ende nuk i është lejuar krijimi i koncept dokumentit nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).

Mungesa e një ligji të veçantë që e rregullon punën në NARIC, mbetet një ndër sfidat më të vështira për NARIC-un dhe kjo për arsye se tashmë ka raste në të cilat Gjykata ka obliguar Ministrinë e Arsimit, konkretisht Këshillin Shtetëror për Njohje (KShNj) dhe Qendrën NARIC, që të zbatojë vendimin e saj për njohje të diplomave.

Humbja e rasteve në gjykatë

Gjatë vitit 2021, NARIC dhe KSHNJ kanë humbur një rast në Gjykatën Themelore në Prishtinë, meqenëse gjykata kishte vendosur që ta njohë gradën Juris Doctor (JD) si ekuivalente me nivelin e tetë të studimeve, pra si doktoratë, gradë kjo e cila në Shtetet e Bashkuara të Amerikës njihet si gradë profesionale pas gradës Baçelor. (*Sistemi i Arsimit të Lartë në ShBA dallon nga ai në Evropë.*) Organet kompetente për njohje të diplomave, NARIC dhe KSHNJ kanë refuzuar një aktvendim të tillë dhe janë ankuar në Gjykatën e Apelit.

Sipas kryesueses së Këshillit Shtetëror për Njohje, Kumrije Gagica, në rastin e përmendur më lartë Avokatura Shtetërore nuk ishte e pranishme në Gjykatë dhe udhëheqësja e NARIC-ut njëherësh edhe kryesuese e KShNj-së, ishte pa mbrojtës ligjor nga zyra ligjore e Ministrisë së Arsimit apo Avokatura e Shtetit. Shqetësuese mbetet mungesa Avokaturës së Shtetit në seanca gjyqësore në të cilat është e thirrur që të mbrojë institucionin, në këtë rast Ministrinë e Arsimit.

Njohja e diplomave nga Komisioni i Ankesave dhe paditë e KShNj-së ndaj tyre

Gjatë vitit 2021, Komisioni i Ankesave dhe zgjedhjes së kontesteve në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MAShTI), ka njohur dy diploma. Qendra NARIC e kishte njoftuar kabinetin dhe zyrën e Sekretares së Përgjithshme, e më pas edhe KShNj-në. Sipas qëndrimit të KShNj-së, NARIC ka paditur Komisionin e Ankesave në gjykatën kompetente. Ende nuk ka ndonjë informatë se çfarë është vendosur me rastet.

Njëra nga palët që kishte marrë vendim për njohje nga ky komision, ishte rishqyrtuar pas atij vendimi nga Këshilli Shtetëror për Njohje dhe kishte marrë vendim për njohje të diplomës, ndërkaq rasti tjetër pasi që kishte arritur të aprovonte padinë ndaj Ministrisë së Arsimit për mosnjohje të diplomës, gjykata e kishte kthyer në rishqyrtim tek ky këshill.

Ndërkohë Ministria e Arsimit ishte ankuar ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Apelit mirëpo gjykata në fjalë kishte kthyer në fuqi vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Tutje Komisioni i Ankesave ka marrë vendim për njohje të kësaj diplome dhe pas këtij vendimi ky komision është paditur nga Qendra NARIC.

Komisioni i Ankesave dhe zgjedhjes së kontesteve në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MAShTI), kishte njohur edhe një diplomë në vitin 2020 për të cilën Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj) kishte nxjerrë vendim negativ bazuar në përgjigjen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri (MASR). Në përgjigjen e MASR thuhej se në *"kolonën e diplomimit, nuk ka të dhëna për diplomën në fjalë" dhe se "MASR nuk është përgjegjëse për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në formular".*

KShNj pas njoftimit për njohje të kësaj diplome nga ana e Komisionit të Ankesave kishte njoftuar autoritetin më të lartë në MAShTI, ish-sekretarin e Përgjithshëm, si dhe ish-Ministren, përmes të cilës ishte kërkuar që ky komision ta tërheq këtë vendim.

Kërkesa ishte bazuar në Ligjin për Arsim të Lartë[3], si dhe Udhëzimin Administrativ për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës[4], në të cilët thuhet se vetëm KShNj është e thirrur për të bërë njohje të diplomave. Këshilli Shtetëror për Njohje kishte pritur 29 ditë për tërheqje të këtij vendimi, por meqenëse ky komision nuk e kishte tërhequr këtë vendim, KShNj kishte paditur Komisionin e Ankesave me 16 qershor të vitit 2020 dhe ende janë në pritje të një përgjigjeje nga gjykata për këtë rast.

3 Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, linku: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761
4 Udhëzimi Administrativ për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, 2018, linku: https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/09/ua-nr-12-2018-parimet-dhe-procedurat-e-njohjese-se-diplamave-gradave-dhe-kualifikimeve-te-shkollave-te-lart-profesionale-dhe-universitare-te-fituar-jashte-republikese-se-kosoves-x.pdf

GRUMBULLIMI I SHKELJEVE DHE PARREGULLSIVE NË PROCESIN E NJOHJES SË DIPLOMAVE PËRGJATË VITEVE

Gjatë viteve të fundit, shpesh janë bërë publike raste të ndryshme të mashtrimit nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë privat e publik, viktima të të cilëve kryesisht ishin studentët.

Pas përfundimit të studimeve themelore Baçelor në ndonjërën nga institucionet e arsimit të lartë në vendin tonë, studentë të ndryshëm kishin vendosur që t'i vazhdonin studimet e tyre Master jashtë vendit. Pas përpjekjes së tyre që të bëjnë validimin apo verifikimin e diplomës së nivelit që kishin përfunduar në Kosovë, rezultonte që ata nuk do të mund të bënin një gjë të tillë.

E për këtë kishte arsye nga më të ndryshmet siç janë, programi ku studenti/ja kishte përfunduar studimet nuk kishte pasur akreditim apo nuk kishte pasur akreditim institucional, të dhënat e studentit/es nuk gjendeshin në Sistemin e Menaxhimit të Informatave për Arsimin e Lartë sepse institucioni kishte regjistruar më shumë studentë se sa ishte paraparë përmes vendimit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim apo që institucioni kishte bërë bartjen e studentëve nga një program në tjetrin pa i informuar ata, e shumë të tjera. Këto ishin problemet kryesore, për të cilat gjatë vitit 2021 ishte marr vendim nga ministrja e Arsimit që të themelohet një komision i cili bën shqyrtimin e këtyre rasteve.

Komisioni për verifikimin e diplomave të lëshuara nga IAL-të në Kosovë

Në nëntor të vitit 2021, Ministria e Arsimit themeloi Komisionin për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) në Kosovë, përmes të cilit synohet të trajtohen rastet të cilat kanë pasur parregullsi në zbatimin e akteve nënligjore për mbajtjen e librave amëz, parregullsi siç është tejkalimi i kuotës së studentëve që mund të regjistrojnë në programe studimore, regjistrimi i studentëve në programe që nuk kanë pasur akreditim, bartja e studentëve nga një program në tjetrin, etj.

Sipas dokumentacioneve të nxjerra nga komisioni, të cilat ORCA i ka në dispozicion përmes procesit të monitorimit, mund të kuptohet se ky komision ka bërë ndarjen e rasteve që kanë probleme në validim të diplomave në dy grupe;

1. Palët që nuk kanë arritur të validojnë diplomat e tyre si pasojë e lëshimeve kur kolegji/universiteti "me vetëdije" ka regjistruar studentë në programe të caktuara duke mos pasur akreditim institucional apo të programit, kur IAL kanë tejkaluar kuotat për regjistrim që i përcakton Agjencia e Akreditimit (p.sh në X kolegji/universiteti në programin Y janë përcaktuar 50 kuota, ndërkaq kolegji/universiteti i ka regjistruar 100 studentë), kur është bërë bartja e studentëve nga një program në tjetrin brenda kolegjit/universitetit pa vetëdijen e studentëve (*p.sh studentët janë duke studiuar infermieri, ndërkaq në sistem figurojnë në psikologji*), etj. si dhe

2. Palët që kanë rënë pre e lëshimeve teknike, siç janë vonesa në dërgimin e Librit Amëz nga kolegji/universiteti në Ministri, apo edhe vonesa nga Ministria për t'i regjistruar studentët në SMIAL.

Sipas metodologjisë së punës, ky komision ka vendosur që për të gjitha rastet kur konstatohen shkeljet si në pikën 1 të paragrafit më lartë, diplomat të shpallen të pavlefshme.

Ndërkaq, për të gjitha rastet e pikës 2, kur konstatohet sipas inspektoratit të arsimit që studentët i kanë ndjekur ligjëratat, i janë nënshtruar provimeve, kanë dëshmi mbi fletëpagesat e semestrave etj. diplomat e tyre do të shpallen të vlefshme.

Ky komision pretendohet të nxjerrë rekomandime për verifikimin ose jo të diplomave të studentëve të diplomuar nga IAL të ndryshme, në baza individuale dhe grupore. Do të evidentojë dhe raportojë shkeljet e konstatuara gjatë procesit të verifikimit. Si dhe do të rekomandojë hapat për sanimin e gjendjes së shkaktuar nga defektet e të dhënave në librat amëz dhe në Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë (SMIAL).

E gjithë kjo është bërë për shkak të ankesave të shumta nga ana e studentëve të diplomuar në universitete publike ose në kolegje private, se të njëjtit nuk po arrijnë që t'i nostrifikojnë diplomat e tyre në Qendrën Kombëtare për Njohje të Diplomave.

Në ndërkohë, në media gjatë vitit që lamë pas ishte diskutuar se numri i diplomave të pavlefshme apo që është e pamundur që të validohen nga kjo qendër, arrin deri në 20 mijë[5].

Arsyet janë të shumta për këtë gjë, mungesa e licencës së institucioneve të arsimit të lartë, mungesa e akreditimit të programeve të ndryshme, tejkalimi i numrit të kuotës së studentëve për program studimor veçanërisht nga kolegjet private, mos-dorëzimi i librave amëz në Ministri të Arsimit, etj.

5 Mbi 20 mijë – numri i diplomave të pavlefshme nga kolegjet private në Kosovë, lajm, 5 nëntor 2021: https://www.koha.net/arberi/295628/studenti-i-kolegjit-privat-tregon-si-doli-i-mashtruar-pa-diplome-valide/

PËRFUNDIME

Qendra Kombëtare për Njohje të Diplomave, viteve të fundit është duke u përballur me probleme të ndryshme të cilat po i pengojnë të bëjnë verifikimin e diplomave të fituara brenda Kosovës dhe probleme të ndryshme që po e pamundësojnë njohjen e diplomave të fituara jashtë vendit. Numri i rasteve që po vazhdojnë të kenë probleme të ngjashme është në rritje.

Një ndër mangësitë më të mëdha dhe qenësore në punën e kësaj qendre dhe këshillit të saj, mbetet mungesa e një ligji të veçantë i cili rregullon të gjithë funksionimin e saj dhe i cili mbron vendimet e kësaj qendre para gjykatave të cilat siç është përmendur edhe më herët në këtë raport, veç kanë marrë vendime për njohje të diplomave të refuzuara për njohje nga Qendra NARIC, vendime të cilat konsiderohen jashtë fuqisë dhe gjykimit të tyre.

Në ndërkohë është vërejtur një fluks i madh i aplikuesve për validim të diplomave me qëllim të përdorimit të tyre jashtë Republikës së Kosovës, të cilët sipas zyrtarëve që kanë pranuar këto dokumente në Qendrën Kombëtare për Njohje të Diplomave, po bëhen me qëllim të shpërnguljes nga shteti.

Vendimi për themelimin e Komisionit për Verifikimin e Diplomave është rrjedhojë e lëshimeve të grumbulluara përgjatë viteve nga ana e kolegjeve private në raste të shumta, e universiteteve publike në raste më të pakta. ORCA është duke e monitoruar nga afër punën e komisionit dhe do të jetë tejet vigjilente që në rastet kur konstatohet se lëshimet e qëllimshme nga IAL-të si në rastet e regjistrimit të studentëve pa akreditim institucional apo akreditim të programit, tejkalim kuotash, bartjet pa vetëdije të studentëve nga programi në program.

Këto raste nuk duhet të kalojnë vetëm me pasojën e mosnjohjes së diplomave të studentëve si viktima të këtyre mashtrimeve, por që me automatizëm këto raste të bëhen lëndë për krimet ekonomike, për Departamentin për Arsim të Lartë në Ministri të Arsimit që t'iu tërhiqen licenca nga ministria dhe të gjitha hallkat zingjirore të përgjegjësisë institucionale.

REKOMANDIME

Për funksionimin sa më efikas të kësaj qendre, fillimisht është i domosdoshëm plotësimi i numrit të stafit apo zyrtarëve relevant dhe të nevojshëm për shqyrtimin e të gjitha aplikimeve që dërgohen në këtë qendër.

Më pas përmirësimi i infrastrukturës ligjore, përmes të cilës kjo qendër do ta ketë funksionimin më të lehtë pa pasur barriera ligjore të cilat e pengojnë në zhvillimin e veprimtarisë së saj.

Krijimi dhe funksionalizimi i disa lloje të databazave që do të përmirësonin cilësinë e punës brenda qendrës dhe imazhin e saj para publikut vendor dhe atij ndërkombëtarë, përmes publikimit të informatave të nevojshme për palët e interesuara për shërbime të ndryshme të cilat i ofron Qendra Kombëtare për Njohje të Diplomave.

LEGJISLACIONI DHE PROCEDURAT E NJOHJES

Qendra Kombëtare për Njohje të Diplomave (NARIC Kosova) aktualisht vepron duke u bazuar në legjislacionin në fuqi si më poshtë:

- *Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës*[6]
- *Udhëzimin Administrativ për verifikimin e dokumentacionit shkollor (Publik dhe privat) për nevojat e kandidatëve që shkollohen jashtë shtetit*[7] ,
- *Udhëzimin Administrativ për Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës*[8].

Diplomat e fituara në universitete publike të rajonit dhe në universitete që gjenden në listat e rangimeve botërore si në Academic Ranking of World Universities (ARWU), Times Higher Education World University Ranking (THE) dhe QS World University Ranking, pasi arrijnë të konfirmohen nga shteti përkatës se janë autentike dhe të vlefshme, miratohen nga Qendra NARIC pa kaluar nëpër Këshillin Shtetëror për Njohje.

Këshilli Shtetëror për Njohje deri tani ka shqyrtuar vetëm aplikimet për njohje të diplomave të cilat stafi i Qendrës NARIC kishte konstatuar se nevojitet një shqyrtim më i detajuar nga anëtari i fushës së studimit prej të cilës është fituar edhe diploma, si dhe nga këshilli në përgjithësi.

Qendra NARIC Kosova, kërkon informacion pranë qendrave të rrjetit evropian të informimit dhe njohjes së diplomave (ENIC – NARIC), mbi statusin e institucioneve të arsimit të lartë, vlefshmërinë e diplomave apo certifikatave, nivelin e tyre sipas Kornizës

6 Ligji për Arsimin e Lartë, linku: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761
7 Udhëzimi Administrativ për Verifikimin e Dokumentacionit Shkollor (Publik dhe privat) për Nevojat e Kandidatëve që Shkollohen Jashtë Shtetit, linku: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10210
8 Udhëzimi administrativ për Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës, linku, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15228

Kombëtare/Evropiane të Kualifikimeve, si dhe informacione tjera shtesë në funksion të njohjes/barasvlerës të diplomës.

Aplikimi për njohje të kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës është i mundur përmes ueb faqes[9] së kësaj qendre.

Detaje të procedurave për njohje, mund të gjenden në Raportin e Monitorimit të NARIC Kosova të publikuar nga ORCA në shkurt të vitit 2020 apo edhe në ueb faqen e përmendur më lartë.[10]

9 Faqja e Qendrës Kombëtare për Njohje të Diplomave: https://naric-ks.online/
10 "Raport i monitorimit të NARIC KOSOVA", shkurt 2020, linku: http://orca-ks.org/ëp-content/uploads/2017/02/RAPORTI-I-MONITORIMIT-T%C3%8B-NARIC-KOSOVA-ALB-03.pdf

DEKLARATË E MOHIMIT TË PËRGJEGJËSISË:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim në kuadër të projektit “Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë në Arsimin e Lartë – QAINT”. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

With funding from

Austrian Development Cooperation

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju
Ministry of Education, Science and Technology

KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center

ORCA organizata për mbjen e cilësisë në arsim

ZSI CENTRUM FÜR SOZIALE INNOVATION CENTRE FOR SOCIAL INNOVATION